

LE CLÉZIO'S *THE DESERT* AMIDST HISTORY AND MYTH ROMANI SHKRETËTIRA I LE CLÉZIO-SË MIDIS HISTORISË DHE MITIT

Dëfrim SALIU¹, Shejnaze AJDINI-MURTEZI², Besa SALIU³

¹ *Department of French Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

² *Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians – Skopje*

³ *High School of Music „Todor Skalovski - Tetoec“ - Tetovo*

^{*} *Corresponding author e-mail: defrim.saliu@unite.edu.mk*

Abstract

The presence of elements of nature and their use by the author in this novel, as well as the relationship between them and the main character, Lalla, the desert girl, is the main concept behind this novel. Le Clézio's attempt to create a special romantic universe, and in turn, the function of myth and history in literature, represents the constellation of beginning and end images that accompany the development of his work.

The term *legend* in its broadest sense, which represents the desert as a geographical location where a historical event occurs, there may be a legendary dimension. The notions of legend, myth, and history revolve around three common points: what are the processes of deformation or elevation that contribute, by a proven historical fact, to the creation of legend, and that make people hesitate the *Desert* between reference and fiction. The transition to the literary field of the historical event is accompanied by a poetization of the episode and the place where it develops. This represents one of the inner aspects of the desert to encourage a poetic journey.

Keywords: *Desert, history, myth, Le Clézio.*

Përmbledhje

Prania e elementeve të natyrës dhe përdorimi i tyre nga autori në këtë roman, si dhe marrëdhëniet midis tyre dhe personazhit kryesor, Lalla-s, vajzës së shkretëtirës, janë koncepti kryesor i këtij romani. Përpyekja e Le Clézio-s për të krijuar një univers të veçantë romantik, dhe nga ana tjetër, funksionin e historisë dhe mitit në letërsi, paraqet konstelacionin e imazheve të fillimit dhe të fundit që shoqërojnë zhvillimin e veprës së tij.

Termi *legjendë*, në kuptimin e tij të gjerë, që paraqet shkretëtirën si një vend gjeografik ku ndodh një ngjarje historike, mund të ketë një dimension legjendar. Nocionet e legjendës, historisë dhe mitit, rrotullohen rreth tri pikave të përbashkëta: cilat janë proceset e deformimit ose lartësimit që kontribuojnë, nga një fakt historik i provuar, në krijimin e legjendës dhe që i bëjnë njerëzit të hezitojnë *Shkretëtirën* midis references dhe trillimit. Kalimi në fushën letrare të ngjarjes historike shoqërohet me një poetizim të episodit dhe vendit ku ai zhvillohet. Kjo paraqet një nga aspektet e brendshme të shkretëtirës i cili shërben për të inkurajuar një udhëtim poetik.

Fjalët kyçe: *Shkretëtira, historia, miti, Le Clézio.*

1. Hyrje

Afrikani (L'Africain) është roman autobiografik i cili u botua në vitin 2004. Është vepër *Shkretëtira* (Désert) është romani më i famshëm i krijimtarisë letrare të Le Clézio-s i cili botohet më 6 maj të vitit 1980. Romani fillon dhe mbaron me tregimin (1909-1910) e Nour-it, një djalë i ri që është pjesë e një karvani të nomadëve Tuareg të njohur si *burrat e kaltër të shkretëtirës*, të cilët përndiqen nga të krishterët dhe luftojnë kundër kolonizimit të Saharasë. Ky popull udhëhiqet nga sheiku i madh Ma-el-Aïnine në drejtim të një toke të premtuar. Historia e Lalës zhvillohet me një dhuratë të paqartë (1970-1975), në Marok afër Tangier-it, në një qytet të ndrojtur. Vajza e vogël jetoj një fëmijëri të lumtur në portat e shkretëtirës.

Por në moshën e adoleshencës, ajo duhej të shkonte në mërgim në Marsejë për të shmangur një martesë të detyruar. Përshtatja me jetën e saj të re, kaq e ndryshme nga ajo që e kishte njohur gjithmonë, ishte mjaft e vështirë. Dy tregimet kryqëzohen gjatë gjithë romanit (Salles, 1999, 25). Kryevepra e krijimtarisë letrare të Jean-Marie Gustave Le Clézio është pikërisht romani *Shkretëtira* (Désert) me të cilin në vitin 2008 e fitoi çmimin letrar *Nobel* (Clézio, 2012, 5). Në roman Le Clézio trajton dy histori në mënyrë paralele.

Megjithëse këto histori ndodhin në kohëra krejtësisht të ndryshme, kjo nuk do të thotë se nuk kanë ngjashmëri me njëra - tjetrën, përkundrazi personazhet kanë shumë ngjashmëri në të dy historitë e këtij romani. Legjenda, sipas Claude Millet, hyn bashkë me mitin, në dispozitivin e legjendares (Millet, 1997, 5). Zërat e shkretëtirës përbëjnë legjendën e saj. Pikënisja e shkretëtirës është një episod autentike e historisë: ngjitja kah Veriu i Mauritanëve, të udhëhequr nga Ma el Aïnine, kur Franca hyn në Maroko, prej vitit 1909 deri më 1912, data e vendosjes së protektoratit francez në Maroko. Datat dhe toponimet ndërhyjnë si dëshmi për autenticitetin e ngjarjeve të rrëfyera.

2. Roli i mitit në romanin *Shkretëtira*

Romani *Shkretëtira* (Désert) është ndërtuar në dy akse narrative paralele, të cilat përbëjnë dy universe krejt të pavarura, të lidhura nga një nyjtim i përbashkët që është shkretëtira. Aksi i parë rrëfen ngjarje reale dhe kolektive të fiseve nomade që jetojnë në shkretëtirën e Saharasë. Narracioni në roman përshkruan marshimin e nomadëve nëpër shkretëtirë pas humbjes së tyre nga ushtria franceze me rastin e kolonizimit të Marokut nga Franca, ndërmjet viteve 1909 dhe 1912.

Aksi i dytë narrativ paraqet një ngjarje fiktive dhe individuale të një vajze të lindur në shkretëtirë, e cila „e zbulon” qytetërimin perëndimor në një periudhë që mund të jetë analoge me atë kur shkruhet edhe vetë libri. Ngjarjet ndodhin në vitet e '80 të shekullit XX (Visoka, 2016, 135). Lalla, pasardhëse e “njerëzve të kaltër (Les hommes bleus)”, pas vdekjes së nënës së saj, do të shkojë të jetojë te tezja e saj, e cila banonte në një lagje të varfër të Marseille-it. Edhe pse më vonë bëhet një modele e njohur revistash, ajo nuk mund t'i ikë tërheqjes së saj ndaj natyrës, popullit të saj dhe dashurisë për Hartani-n, bariun e ri.

Romani fillon me udhëtimin e nomadëve, të quajtur “njerëzit e kaltër (Les hommes bleus)”, luftëtarët e shkretëtirës. Ky udhëtim fillon nga jugu për në veri. Ata çdoherë janë në lëvizje, sepse janë të përndjekur nga të krishterët, por, edhe të ujit dhe të një vendi të përkohshëm për jetë më të rehatshme. Udhëheqësi i tyre është Ma el Aïnine, të cilin Le Clézio e paraqet si një njeri të urtë, me virtyte të larta të një udhëheqësi të një fisi nomad. Në këtë roman Le Clézio bën përshkrimin e çdo ngjarjeje apo lëvizjeje që u ndodh gjatë rrugëtimit njerëzve të kaltër nga jugu kah veriu, dhe kthimin e tyre mbropa.

Historia e këtij populli që përshkruhet në pjesën e parë, është e lidhur apo ndërthuret me historinë e dytë e cila ndodh shumë dekada më vonë, megjithatë ajo nuk humb nga vlera dhe ngel përsëri mirë e kuptueshme. Në fillim të romanit përshkruhen peripecitë e këtyre njerëzve nëpër shkretëtirë, lufta e tyre për ekzistencë me kushtet e rënda që mbizotërojnë në shkretëtirë, era e shpeshtë dhe rëra që u shkakton çarjen e buzëve. Dhimbjen e shton edhe mungesa e të mirave materiale, e ushqimit dhe e ujit. Përveç kushteve natyrore me të cilat beduinët janë mësuar të ballafaqohen çdo ditë, ata duhet të ballafaqohen edhe me ndjekjen nga ana e krishterëve dhe armatës franceze.

E gjithë kjo ndodh në sytë e të riut Nour, emri i të cilit ka domethënien e dritës në gjuhën arabe. Nour-i do të shoqërojë luftëtarin e verbër dhe do të jetë krah për krah me Ma el Aïnine-in deri në agoninë e tij (Clézio, 2012, 44). Protagonisti i pjesës së parë të romanit, Nour-i dëgjon gjithmonë historitë që rrëfente udhëheqësi Ma el Aïnine, për betejat e tij kundër spanjollëve, burimet e ujit që buronin në shkretëtirë, shiun që mbulonte fushat shterpë, etj. Nour-i e dëgjonte, jo vetëm, sepse ai ishte prijësi i tyre në rrugëtimin nëpër shkretëtirë, por edhe për shkak se ai ishte udhëheqës shpirtëror, njeri që njihte yjet, që kishte recituar Kuranin pa asnjë gabim që në moshën shtatë vjeçare.

Ma el Aïnine-i ishte njeri mrekullibërës, siç ishte edhe plaku Al Azrak në rrëfimet që Aamma i tregonte Lalla-së. Kështu, një herë atij i kishte ardhur një plak me të birin e tij, i cili ishte i verbër dhe e kishte lutur që t'ia kthej shikimin. Al Azrak-u e kishte pyetur plakun se a do të ishte pajtuar nëse si kusht për t'ia kthyer shikimin të birit të tij do të ishte verbërimi i tij. Plaku pa menduar ishte përgjigjur pozitivisht. Atëherë Al Azrak-u ia kishte kthyer shikimin të riut dhe, duke parë sinqeritetin e plakut, edhe atij ia kishte lënë shikimin.

Në këtë roman, nëpërmjet ndodhive, Le Clézio i përshkruan mrekullitë e njerëzve të urtë të shkretëtirës, por edhe çiltërsinë e njerëzve të rëndomtë, shpirtin e tyre të pastër, edhe pse në kushte mjaft të rënda, ata janë të kënaqur me jetën e tyre. Vetë emri i sheikut Ma el Aïnine, ka një domethënie të rëndësishme për popullin e shkretëtirës. Kur lindi Ma el Aïnine, atë e pagëzoi me këtë emër të bukur nëna e tij që në gjuhën arabe do të thotë *syri i ujit*, për arsye se nëna e tij qau nga gëzimi kur ai lindi.

I ballafaquar me shumë vështirësi gjatë jetës, ai nuk do të ndalë rrugëtimin e tij edhe atëherë kur ndodhet para greminës, siç është rasti i mostërheqjes së tij në luftë kundër senegalezëve dhe gjeneralit francez Monier, ku pothuajse i gjithë fisi i njerëzve të kaltërt do të vriten. Moment prekës në historinë e parë të romanit *Shkretëtira* është edhe vdekja e sheikut Ma el Aïnine, të cilën autori e përshkruan me fjalët: *Pak para agimit, kur ajri jashtë është i heshtur dhe i palëvizshëm, kur nuk dëgjohet asnjë zë, asnjë insekt, Ma el Aïnini vdiq. Lalla Mejmuna, që i mban dorën, e kupton dhe shtrihet pranë njeriut që ajo do, fillon të qajë pa i mbytur lotët e saj* (Clézio, 2012, 370).

3. Historia si pjesë e rrëfimit letrar

Në pjesën e dytë të romanit, Le Clézio trajton historinë që ndodh disa dekada më vonë. Për dallim nga historia e parë, ku ai në mënyrë koncize, precizon kohën kur ngjasojnë rrugëtimet e nomadëve. Te pjesa e dytë apo historia e dytë nuk kemi të dhëna të sakta se kur ndodh ngjarja që përshkruhet në roman, por kjo kuptohet nga përshkrimet e vendeve dhe personazhit kryesor të veprës, Lalla Hawa-së, e cila është me prejardhje nga njerëzit e kaltërt e që kishte lidhje farefisnore me Nour-in nga historia e parë, përkatësisht është njëra nga stërmbesat e tij. Me gjithë faktin se historitë kanë zhvendosje kohore, ato janë të ngjashme me njëra - tjetrën, por trajtojnë dy botëra të ndryshme.

Ngjashmëri ka edhe mes Nour-it të vogël dhe Lalla-së. Lalla si fëmijë dëgjonte këngët në gjuhën *chleuh*, që ia këndonte e ëma gjersa ishte ende gjallë, thuajse po të njëjtat këngë të kënduara në gjuhën *chleuh* i dëgjonte edhe Nour-i në halucinacionet e tij. Nour-i me vëmendje dëgjonte rrëfimet e sheikut Ma el Aïnine, ndërsa rrëfime të ngjashme dëgjonte Lalla prej hallës së saj, Aamma. Personazhi kryesor dhe heroina e pjesës së dytë të romanit *Shkretëtira* është vajza e re, Lalla Hawa, e cila mbetet jetime që kur ishte foshnje. Ajo do të rritet dhe edukohet në gjirin e familjes së hallës së saj, Aamma, por nuk do të ketë mundësi për shkollim, asnjëherë nuk do të mësojë shkrim dhe lexim. Lalla-s i pëlqente të dalë në natyrë, ku pjesën më të madhe të ditës e kalonte jashtë.

Qysh në momentin e parë kur ajo do ta njohë bariun e ri shurdhmemec me emrin Hartan-i, Lalla nuk do t'i ndahet atij (Clézio, 2012, 83). Qëndrimi i saj me Hartan-in i pëlqente shumë, sepse ai i dinte të gjitha sekretet e shkretëtirës. Hartan-i nuk ishte si djemtë e tjerë. Askush nuk e dinte saktësisht nga vinte ai. Thuhej se Hartan-in e kishte lënë një njeri nga jugu, rrëzë një burimi, si foshnje të vogël, të mbështjellë me një leckë të kaltërt, që me gjasë duhej t'u takonte njerëzve të kaltërt. Të gjithë e llogarisnin atë si të çuditshëm, as djemtë e hallës Aamma nuk e donin atë, thoshin se ai është i pushtuar nga shejtani, është një magjistar, se të hedh syrin e keq.

Thoshin se ai s'ka as baba e as nënë, se ka ardhur nga askund. Mirëpo, Lalla nuk ua varte veshin, ajo nuk i pranonte paragjykimet që i kishin të gjithë për Hartan-in, përkundrazi ajo e donte shumë atë. Asaj i pëlqenin duart e Hartani-t në trupin e saj, i pëlqenin shushurimat e tij në vesh, i pëlqente kur ai ia zbulonte sekretet e erërave nën gurët e shkretëtirës. Kohën kur Lalla nuk ishte me Hartan-in, shkonte ta vizitojë plakun Naman, peshkatarin, njeriun me shpirt shumë të mirë, të cilin Lalla e donte shumë edhe për arsye se ai i tregonte asaj histori të mrekullueshme për delfinët e detit dhe për zogun e bardhë. Lalla atë e llogariste si gjyshin e saj.

Ai nuk ishte si të tjerët, ishte një njeri i gjatë dhe i hollë, me shpatulla të gjëra, por ishin pikërisht sytë e tij me një ngjyrë të jashtëzakonshme, të kaltërt me të gjelbërt për të cilët Lalla ktheheshte në bregun e detit. Një tjetër personazh që jeton në imagjinatën e Lalla-s ishte ai i Es Ser-it, që në përkthim ka domethënien e sekretit, e që ishte personazhi që e lironte Lalla-në nga ankthi. Pikërisht, përmes këngës që i dukej se e dëgjonte prej tij, Lalla-së do t'i paraqitet edhe parandjenja për vdekjen e Naman peshkatarit.

Kënga jehonte përbrenda Lalla-s, ajo e njihte këtë këngë të kënduar nga Aamma, por tani nuk i kuptonte mirë fjalët, sepse këndohej nga një zë i largët në gjuhën *chleuh*: „Një ditë, oh, një ditë, korbi do të bëhet i bardhë, deti do të thahet, do të gjejmë mjaltë në lulet e kaktusit, do të bëjmë një shtrat me degët e akacies“ (Clézio, 2012, 188). Duke ndier zërin e Es Ser-it në vete, Lalla në vend që të shkojë nga shtëpia e Aamma-së, aty ku jetonte, ajo shkon ngadalë drejt anës tjetër të qytetit, aty ku jetonte Namani, peshkatarin. Me të arritur te shtëpia e Namanit gjen derën e hapur dhe pa dritë brenda. Naman-in e gjeti të shtrirë mbi dyshekun e tij, në të njëjtën pozitë që e kishte lënë.

Ai merrte frymë ende, Lalla e thërret disa herë në emër, por ai nuk kishte fuqi të përgjigjej. Lalla ishte plot ankth, kishte shpresë se Naman-i nuk do të ikte nga kjo botë, do të donte ta dëgjonte atë tek i fliste, donte që ai të vazhdonte t'i tregojë asaj histori të mrekullueshme, t'i fliste për zogun e bardhë, për detin, për qytetet matanë detit. Por, Namani plak jep shpirt duke fjetur në krahun e Lalla-së, diku natën para agimit. Para vdekjes së Naman-it, Lalla ishte në raporte shumë të acaruar me hallën e saj, Aamma-në dhe me gjithë familjen e saj (Salles, 1999, 97). Përkeqësimi dhe mosdashja që Lalla të kthehej te halla, ishte nga arsyeja se ajo këmbëngulte që ta martojë Lalla-në. Lalla kurrë nuk besonte se halla e saj do t'i bënte shtypje që ta pranojë një burrë të cilin asnjëherë nuk e kishte parë më herët. Për më tepër, situatën rëndonte edhe dashuria e saj ndaj Hartani-t.

Lalla preferonte që zgjedhjen ta bënte vetë, çdoherë e mendonte veten të lirë, por për fat të keq, nuk ishte kështu në rrethin e familjes së hallës ku jetonte ajo. Insistimi i hallës dhe djemve të saj, për t'i gjetur Lalla-së një burrë shtohet edhe për faktin se ata kishin nuhatur dashurinë e saj me Hartani-n, të cilin asnjë nga familja nuk e preferonte. Me ndodhitë në familjen e hallës, por dhe vdekjen e Naman-it, dëshira e Lalla-së për të ikur nga familja tashmë ishte e pakthyeshme. Vizitat e shpeshta të njeriut me kostum gri në jeshil te shtëpia e hallës, pikërisht për ta parë Lalla-n, ia shtonin shqetësimin asaj në familje. Përpos gjithë këtyre arsyeve, Lalla kishte edhe një arsye tjetër madhore, që ishte një fshehtësi e saj dhe e Hartani-it, fakti pra, që ajo ishte shtatzënë me të. Ajo vendosi të largohet, pa i thënë asgjë askujt. Kështu, një mëngjes, para lindjes së diellit, nisat për rrugë. Pa ia hedhur fare sytë hallës së saj e cila flinte.

Para largimit ajo e kishte të rëndësishme vetëm takimin me Hartani-n, atij do t'i thoshte se vetëm ai do të jetë burri i saj dhe do t'i tregonte atij se së bashku prisnin një fëmijë. Le Clézio do të ndalet në përshkrimin e gjithë detajeve të takimit të fundit të Lalla-së me Hartani-n. Ishte një natë shumë e bukur, yjet shëndrisnin, qielli mbi ta mbipopullohet me yje që bënin ngjyra të ndryshme. Lalla nuk kishte parë kurrë më parë natë kaq të bukur. Ajo ndjente ngrohtësinë e trupit të Hartani-t, që ishte ngjitur me të saj. Të dy parandjenin se ky ishte takimi i tyre i fundit.

4. Rrugëtimi si pjesë e rëndësishme e romanit

Pjesa tjetër e historisë së dytë të romanit, jo rastësisht, është titulluar *Jeta te skllëverit* ku Le Clézio i referohet jetës së Lalla-së në Marsejë dhe Paris, por edhe jetës së emigrantëve tjerë në Francë (Clézio, 2012, 235). Ky emërtim është shumë domethënës, pasi që për Le Clézio-m jeta e emigrantëve në Francë është shumë e vështirë. Përpos që njerëzit e botës moderne i quan skllëvër, ai e ka të qartë se edhe jeta e njerëzve të *lirë* të shkretëtirës do të shndërrohet në skllavëri (Michel, 1993, 280). Njohja e parë me botën moderne nuk do të jetë e këndshme për Lalla-n. Me të zbritur nga anija, kupton se në këtë anë të detit nuk do të priten me lule.

Kontakti i parë do të jetë me policin francez, i cili do të mbushë pyetësorin për emigrantët, në lidhje me qëndrimin e tyre në Francë. Lalla thotë se do të punojë në një familje. Ajo ishte e rraskapitur, e pangrënë, ndodhej në një dhomë me shumë njerëz të tjerë. Aty mezi merrte frymë, ajri ishte i rëndë. Gjendjen ia rëndonte edhe më tepër shtatzënia e saj (Clézio, 2012, 256). Duke bredhur rrugëve të qytetit ajo alivanoset, por fatmirësisht, atë e ndihmon një njeri me emrin Paul Estève, të cilit i vinte erë e rëndë. Paul-i e shkruan emrin e tij në një copëz letre për t'i ofruar ndihmë asaj në rast nevojë, por për Lalla-në letra nuk kishte vlerë pasi ajo nuk dinte shkrim-lexim.

Ditët e para në qytet ajo do t'i kalojë duke bredhur rrugëve të qytetit, shpesh mbante me vete ndonjë portokall apo edhe copë buke për ta shuar urinë. Duke bredhur në qytet ajo do të takojë një fëmijë me emrin Radiz, i cili ishte një lypës simpatik. Lalla shpesh bisedonte më të, i interesonte se ku jetonte dhe si jetonte ai. Radiz-i i tregon Lalla-së se ai kishte bosin e vet, se gjithë ditën bredhte rrugëve të qytetit duke lypur lëmoshë dhe në fund paratë i dërgonte te bosin. Përkundër kësaj pune që bënte, ai e konsideronte bosin e tij si një njeri të mirë. Radiz-i jetonte në një shtëpi që bosin e kishte marrë me qira, bashkë me shumë fëmijë të tjerë. Radiz-in e kishte shitur e ëma e tij te bosin qysh kur ishte i vogël.

Ai nuk mund të ikte nga aty, ngaqë bosin kishte paguar për të, madje ai mendonte se nëna e tij ka bërë mirë, sepse ajo nuk do të mund të kujdesej për të, ngaqë ishin shumë të varfër. Bosin u ofronte ushqim atyre dhe, nganjëherë, edhe pak para. Lalla-s i pëlqente të bisedojë me lypësin Radiz, i cili i parashtronte pyetje nga më të çuditshmet asaj, por edhe i tregonte për taktikat që përdorte për të fituar sa më shumë para për bosin. Radiz-i thoshte se edhe pak kohë nuk do të duhej

të lypte lëmoshë, por me ca të rinj tjerë do të kalonte në punën e vjedhjeve nëpër vetura dhe shtëpi të cilat bosi i kishte caktuar më parë. Porse, ai ende nuk ishte i trajnuar mirë për këtë zanat, sepse thoshte, kjo punë ishte paksa e rrezikshme.

Në Francë, Lalla do të gjejë një punë në hotelin *Sainte-Blanche*, pronari i së cilit do t'i ofrojë edhe një dhomë ku ajo do të mund të jetonte. Në këtë hotel, Lalla do të punojë si pastruese. Kjo nuk do të jetë një punë e lehtë për të, sepse hoteli ishte shumë i ndyrë, ngase aty jetonin kryesisht migrantë nga Afrika, në dhoma të përbashkëta. Pra, kushtet ku jetonte dhe punonte ishin mizore, andaj i dukej se në atë hotel mbretëronte vdekja. Të gjallët aty, për Lalla-në, ishin vetëm silueta të vdekurish (Clézio, 2012, 263). Ajo shpesh mendonte se ku mund të shkonte apo të zhdukej nga aty. Do të donte të gjente një vend të fshehtë, si më parë, në shpellën e Hartani-t, nga ku do të mund të shihte vetëm detin dhe qiellin.

Meqë me Radiz-in e vogël takohej shumë shpesh, një ditë Lalla vendosi të ulet në një restorant. Aty, krejt rastësisht, do t'i takojë një fotograf, i cili do të mahnitet me bukurinë e Lalla-së (Clézio, 2012, 310). Në takimin tjetër me fotografin, ajo do të bëhet fotomodelja e tij. Së shpejti emri dhe fytyra e saj do të ndodhen në revistat më të njohura të Francës, meqë ajo ishte e bukur si Nefretiti dhe fytyra e saj kishte ngjyrën e bakrit. Fotografi do të fitojë para të majme nga fotot e Lalla-s. Ajo, pothuajse asnjëherë nuk i mbante paratë për vete, ose i merrte fotografi ose shpesh ia jepte Radiz-it.

Paratë për Lalla-në nuk kishin vlerë. Ajo bëhet e famshme edhe në Paris, ku kishte takime të shpeshta me gazetarët. Lalla nuk e kishte mendjen te profesioni që e ushtronte, për shkak se kishte nostalgji të madhe për matanë detit, për vendlindjen e saj. Radiz-i, lypësi i vogël, tashmë ishte bërë i përkryer në vjedhje, gjë për të cilën i fliste Lalla-s më parë. Ai vidhte nëpër makina të cilat i ndiqte paraprakisht. Një ditë duke vjedhur brenda një makine, do të hetohet nga policia. Arrin t'i ikë policisë e cila e ndiqte. Në momentin e daljes në një rrugë afër detit, pak metra para se të arrijë t'u shmanget policëve, pak metra para se të arrijë në bregun e detit, aty ku e sheh shpëtimin e tij nga policët, pikërisht aty do të goditet nga autobusi.

Trupi i tij do të ndahet në dy pjesë nga goditja e autobusit. Njerëzit do të mblidhen, por trupi i hajdutit tashmë është i mbuluar me një leckë të zezë (Clézio, 2012, 361). Një ditë, para agimit, ashtu siç bënte çdoherë edhe kur ikte në mëngjes nga shtëpia për ta vizituar Naman-n, peshkatarin, ashtu siç iku nga vendlindja e saj pa e paralajmëruar askënd, po në të njëjtën mënyrë ajo do të ikë edhe nga fotografi i saj. Meqë nuk dinte shkrim, për t'i lënë një mesazh atij, Lalla e vizaton me sapun shenjën e fisit të saj për ta falënderuar fotografin, ashtu siç vizatonte në revistat në Paris kur i kërkonin autograf.

Ikja e saj ishte kthim mbrapa, për në shkretëtirë, atje ku ndjehej në shtëpi, atje ku ndihej e lirë, duke menduar për Hartani-n dhe vendin ku peshkonte plaku i mençur Naman. Derisa anija i afrohej bregut në anën e shkretëtirës, brenda barkut të saj të fryrë, ajo ndjen lëvizjet e foshnjës që lëviz, mendon për jetën më të, për ëndrrat e foshnjës dhe fillon të këndojë më vete, gjithnjë e më shumë duke ngritur zërin, këndon po atë këngë që e kishte mësuar nga e ëma: "...një, ditë, oh, një ditë, nuk do të ketë më helm në gojën e gjarprit dhe plumbat nuk do të sjellin vdekjen, sepse atë ditë, do të lë të dashurin tim..." (Clézio, 2012, 373).

Pasi arrin në vendlindje, Lalla do të drejtohet kah vendi ku jetonte Naman-i, peshkatarin, por vendi aty tani ishte bosh, plazhi shtrihej i braktisur në errësirën e natës. Ishte e lodhur dhe rraskapitur, e ndjen se momenti i lindjes po afrohej, andaj edhe e përshkon një frikë, sepse ajo e dinte që ndodhej vetëm dhe askush s'kishte për t'i ardhur në ndihmë. Me gjithë shpirtin e saj thërret emrin e Hartani-t, ishte e vetme, nuk kalon shumë kohë kur ndjen zërin e fëmijës së saj që vjen në jetë. Me dhëmbë pret kordonin e fëmijës, duke mos e lëshuar atë nga dora (Salles, 1999, 133).

Mezi merr fuqinë të ngrihet për t'u drejtuar nga deti, me fëmijën në duar, arrin te uji i njelmët dhe me kujdes e lan atë. Në vazhdimësi ndjen të dridhurat e fëmijës që qan. Kthehet mbrapa te fiku i vjetër i Naman-it, gërmon tokën me gishtat e saj dhe e varros placentën aty. Ajo mbyll sytë, por pa fjetur ëndërron, gjersa e bija e saj e vogël thith gjirin e saj. Lalla me Hawa-në e vogël pret nën hijen e fikut që t'i vijë dikush në ndihmë. Ajo e dinte se dikush do të kthente aty, si më herët, gjithmonë dikush kthente nën hijen e ëmbël dhe të freskët të fikut (Clézio, 2012, 385).

5. Përfundimi

Romani *Shkretëtira* është roman historik që jep një pamje të qartë të jetës së popujve afrikanë në shkretëtirën e Saharasë, peripecitë që ata i hasin çdo ditë, luftërat fetare, zhvillimin e jetës dhe rrugëtimin e tyre që i ndjek tërë jetën. Aspekti fikcional i romanit është historia imagjinare e Lallas, e cila është një vajzë që ka lindur në shkretëtirë, por që udhëton për ta zbuluar dhe për ta parë botën e qytetëruar, siç ishte në atë kohë, Franca. Sa i përket rolit të mitit në letërsinë e Le Clézio-s, është e pashmangshme të mos përmendim ndodhitë nëpër kohë që kanë lënë gjurmë në letërsinë e tij, që nga fëmijëria e tij e deri në ditët e sotme.

Ai është ende aktiv me shkrimet e tij. Duhet përmendur udhëtimin e tij të parë për në Afrikë, kontaktet e tij të para me kulturat afrikane, me peizazhin e thatë të Afrikës, kontaktin e tij me shkretëtirën. E gjithë kjo do të lërë gjurmë në mendjen dhe shpirtin krijues të Le Clézio-s (Cortanze, 2009, 95). Historia si pikënisje e rrëfimit të romaneve si *Procesverbali*, *Shkretëtira* dhe *Afrikani* është ajo që e ndjek gjatë gjithë krijimtarisë së tij romaneske. Çdo roman është i bazuar në mitin e një populli apo një vendi. Le Clézio e percepton dhe e paraqet atë në formë të shkruar në veprat e tij. Ndërsa, historia si rrëfim i ngjarjeve historike të vendeve të ndryshme, ndikon mjaft që Le Clézio të lexohet dhe perceptohet shumë më lehtë nga lexuesit (Roussel-Gillet, 1999, 154).

Referencat

- [1]. Clézio, J.-M. G. (1980). *Désert*. Paris: Gallimard.
- [2]. Clézio, J.-M. G. (2012). *Shkretëtira*. Tiranë: Toena.
- [3]. Cortanze, G. d. (2009). *J. M. G. Le Clézio*. Paris: Gallimard.
- [4]. François, C. (2008). *Désert de Le Clézio*. Paris: Bréal.
- [5]. Eliade, M. (1996). *Mythes, rêves, mystères*. Paris: Gallimard.
- [6]. Eliade, M. (2019). *Miti dhe realiteti*. Tiranë: Pika pa sipërfaqe.
- [7]. Jauss, H.R. (1978). *Pour une esthétique de la réception*. Paris: Gallimard.
- [8]. Lévi-Strauss, C. (2009). *Mythe et signification*. Paris: Seuil.
- [9]. Michel, J. (1993). Épreuves du livre. Réflexions sur Étoile errante de J. M. G. Le Clézio. *Les Lettres romanes no. 47*, 280.
- [10]. Millet, C. (1997). *Le Légendaire au XIX siècle, poésie, mythe et vérité*. Paris: PUF.
- [11]. Roussel-Gillet, I. (1999). *J. M. G. Le Clézio, écrivain de l'incertitude*. Paris: Ellipses.
- [12]. Salles, M. (1999). *Étude sur Le Clézio : Désert*. Paris: Ellipses.
- [13]. Visoka, A. (2011). *Koha e shkrimit*. Prishtinë: 99-AIKD.
- [14]. Visoka, A. (2016). *Shkrim dhe receptim*. Prishtinë: Faik Konica.